



RADIO  
TELEVISIONI  
SHQIPTAR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME  
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT

---

Tiranë, më 11. 09. 2018

### ***NJOFTIM PER SHTYP***

Dje vizitoi RTSH - në një delegacion i lartë i Administratës Shtetërore të Radios dhe Televizionit të Republikës Popullore të Kinës kryesuar nga Zv. ministri z. Nie Chenxi.

Ishte e pranishme në takim dhe ambasadorja e Republikës Popullore të Kinës në Republikën e Shqipërisë znj. Jiang Yu.

Drejtori i Përgjithshëm i RTSH - së Thoma Gëllçi theksoi rëndësinë e kësaj vizite dhe aspektin shumëplanësh të marrëdhnieve të RTSH me Administratën Shtetërore të Radios dhe Televizionit të Republikës Popullore të Kinës, si në pjesën dypalëshe, ashtu dhe si rrjedhojë e qënies anëtarë të Bashkimit të Transmetuesve të Azisë dhe Paqësorit - ABU. Një kontribuuese e veçantë është Ambasada e Republikës Popullore të Kinës edhe si rrjedhojë e angazhimit personal të Ambasadores Znj. Jiang Yu. Por sigurisht pjesa thelbësore e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit është me CRI (China Radio International) për radio stacionin e Cërrikut. Z. Gëllçi vlerësoi palën kineze si një partner të madh e të rëndësishëm për zhvillimin e RTSH - së.

Zv. Ministri Nie Chenxi nënvizoi miqësinë tradicionale mes dy popujve ku bashkëpunimi në fushën e medias është i domosdoshëm për njohjen reciproke të dy popujve. Pala kineze ofroi asistencë për programe, trajnim stafi dhe bashkëpunime në fusha të ndryshme.

Drejtori i Përgjithshëm i RTSH - së vlerësoi ndihmën e specialistëve kinezë që nga themelimi i televizionit shqiptar dhe ngritja e rrjetit të transmetimit. Ai gjithashtu u shpreh se një hallkë e rëndësishme lidhjeje është dhe seksioni shqip në radio televizionin kinez.

Zv. Ministri Nie Chenxi vlerësoi ndihmën e RTSH - së për transmetimet nga radio stacioni i Cërrikut dhe u shpreh i bindur se, edhe me ndihmën e Ambasadës së Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri ky bashkëpunim do të thellohet dhe intensifikohet.

Në përfundim të takimit u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit mes RTSH dhe Administratës Shtetërore të Radios dhe Televizionit të Republikës Popullore të Kinës me qëllim intensifikimin e thellimin e

---

Address: "Ismail Qemali" Street, No.11, Tirana, Albania

Phone: + 355 4 22 27 512  
Fax: + 355 4 22 27 745  
e-mail: info@rtsh.al

[www.rtsh.al](http://www.rtsh.al)

marrëdhënieve dhe bashkëpunimiy, Marrëveshje Liçensimi për programe të ndryshme që pala kineze i ofroi palës shqiptare si dhe Memorandum Mirëkuptimi mes CCTV + dhe RTSH për shkëmbimin e lajmeve.

Address: "Ismail Qemali" Street, No.11, Tirana, Albania

Phone: + 355 4 22 27 512  
Fax: + 355 4 22 27 745  
e-mail: info@rtsh.al

[www.rtsh.al](http://www.rtsh.al)

